



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.10.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Myllët rasti më nr. AKK-03-2440/12, për z. Shukri Buja- Kryetar i Komunës se Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se nuk ushtron më funksion udhëheqës në biznesin e tij privat pasi që ka emëruar një person tjeter që ta përfaqësoj biznesin e tij.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapar sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre, ka filluar shqyrtimi i lendet me numër protokollit AKK-03-2440/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Shukri Buja- Kryetar i Komunës se Lipjanit.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Kryetar i Komunës së Lipjanit, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), si person i autorizuar dhe pronar në biznesin D.P.H. "Bulevardi"-Ferizaj, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-05, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar

procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

z. Buja ka bërë kërkese që të takohet dhe dëshiron të njoftohet më detal për situatën që dyshohet për Konflikt te mundshëm te Interesit.

Pas kërkësës që ka bërë z.Buja për tu takuar dhe të informohet më detalisht me faktet që posedon Agjencia, zyrtari i AKK-se që është përgjegjës për rastin, ka qenë në takim dhe e ka njoftuar me faktet që posedon Agjencia.

Gjatë takimit është njoftuar z.Buja, se për cilën situate bëhet fjalë, ndërsa ai është shprehur i gatshëm për bashkëpunim, por na ka njoftuar se për çështjen në fjale lidhur me angazhimin e tij në biznes nuk qëndron, pasi qe nuk ushtron asnjë aktivitet tjetër por vetëm ka mbetur si emër në kohën kur është regjistruar biznesi, sepse tash atë biznes e ka të lëshuar me qira, dhe nuk ushtron aktivitet por merr vetëm fitimin nga qiraja, ku edhe në formularin për deklarim të pasurisë e ka deklaruar si të hyra nga qiraja, mirëpo është zotuar se në afatin ligjore do të bëjë ndryshimet e kërkuar dhe do të shembang çfarë do situate që mund të shkaktoj Konfliktit të Interesit.

Me datën 21.09.2012 zyrtari i lartë z.Shukri Buja i ka sjell në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, se janë bërë ndryshimet e kërkua, dhe nuk mbanë me pozitën e personit te autorizuar në biznesin D.P.H. "Bulevardi".

Andaj ne bazë te dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z.Shukri Buja- Kryetar i Komunës së Lipjanit, nuk gjendet më në situatën e përshkuar si Konflikt të mundshëm te Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik pasi që ka bërë ndryshimet e kërkua nga Agjencia kundër Korruptionit në biznesin ku ishte pronar dhe person i autorizuar, ndërsa pas ndryshimeve të bëra ka mbetur vetëm pronar dhe biznesin do ta përfaqësoj personi i emëruar nga z.Shukri Buja.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik si, Kryetar i Komunës dhe person i autorizuar ne biznes Private.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

